



Vend Vakant : Ekspert

Titulli i projektit: “Fshatrat Sipërmarrës”

Numër kontrate: 00095613 dhe 00101336

Kohëzgjatja e projektit: 01/06/2019 to 31/01/2020

Donator: Financuar nga UNDP - **Programi Rajonal mbi Demokracinë Vendore në Ballkanin Perëndimor (ReLOaD)**

Qëllimi i projektit:

1. Të rrisë përfshirjen e të rinjve në zonat rurale në vetë-punësim ose nismat e sipërmarrjes sociale si një kontribut i drejtpërdrejtë në zhvillimin e tyre ekonomik dhe social.
2. Rritja e shkallës së absorbimit të burimeve të financimit të dedikuara për start-up-et rinore dhe aktivitetet bujqësore në rajo

Informacion për projektin

Qëllimi i këtij projekti është të rrisë shkallën e shfrytëzimit të potencialit ekonomik të zonave rurale nga të rinjtë që jetojnë dhe punojnë në komunën e Lezhës. Kjo do të kontribuojë në rritjen ekonomike dhe menaxhimin e mirë të pyjeve dhe kullotave. Më konkretisht, projekti do të synojë të rrisë përfshirjen e të rinjve rural në vetë-punësimin ose nismat e sipërmarrjes sociale si një kontribut të drejtpërdrejtë në zhvillimin e tyre ekonomik dhe social. Nëpërmjet aktiviteteve të tij pritet gjithashtu të rritet shkalla e absorbimit të burimeve të financimit të dedikuara për bizneset e reja dhe aktivitetet e reja të biznesit dhe bujqësisë në rajon. Ky projekt do të adresojë nevojat dhe kufizimet në aftësimin profesional



Ky projekt financohet nga
Bashkimi Evropian



Empowered lives.
Resilient nations.

Programi Rajonal mbi Demokracinë Vendore në Ballkanin Perëndimor – ReLOaD financohet nga Bashkimi Evropian dhe zbatohet nga Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP).



dhe aftësitë për të ndërmarrë iniciativa për vetëpunësim dhe angazhim në ndërmarrjet sociale (rreth 20 të rinj të papunë, 15 prej të cilëve janë gra).

Shërbimi i kërkuar:

Kryerja e një analize të situatës ekonomike dhe sociale të grupeve vulnerabël me fokus në të rinjtë në zonat rurale të të gjitha njësive administrative për mundësitë e zhvillimit ekonomik, kërkesat e tregut të punës, kërkesat e aftësive profesionale dhe identifikimin e zonave potenciale për vetëpunësim dhe krijimin e bizneset sociale.

Koha e parashikuar për përmbushjen e shërbimit të kërkuar është: 10 ditë pune për kryerhen e analizës dhe hartimin e raportit final.

Rezultatet e pritshme:

Raport vlerësimi i situatës socio-ekonomike të grupeve vulnerabël në zonat rurale të të gjitha njësive administrative për mundësitë e zhvillimit ekonomik, kërkesat e tregut të punës, kërkesat e aftësive profesionale dhe identifikimin e zonave potenciale për vetëpunësim dhe krijimin e bizneset sociale.

Vendi i kryerjes së shërbimit: Lezhë, Shqipëri

Kriteret, kualifikimet and eksperiencia:

1. Preferohen kandidatë të cilët jetojnë në qytetin e Lezhës,
2. Master Shkencor ose Phd në Shkenca Ekonomike apo Sociale ; preferohet të paktën 3 vjet eksperiencë e vërtetuar pune në fushën e kërkimit.
3. Eksperiencë profesionale pune me organizatat e shoqërisë civile, apo institucionet vendore dhe ofruesit e shërbimeve.
4. Eksperiencë të mëparshme si trajner në fushën e të drejtave të fëmijëve dhe atyre me aftësi të kufizuar.



Ky projekt financohet nga
Bashkimi Evropian



Empowered lives.
Resilient nations.

Programi Rajonal mbi Demokracinë Vendore në Ballkanin Perëndimor – ReLOaD financohet nga Bashkimi Evropian dhe zbatohet nga Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP).



Kushtet për shërbimin:

- Disponueshmëri për të përmbushur detyrimet lidhur me shërbimin e kërkuar, sipas afatit kohor të përcaktuar;
- Të mbrojnë konfidencialitetin e informacionit dhe të dhënave që do mund të merren gjatë ofrimit të konsulencës;
- Të mundësojë dorëzimin e timesheet, duke raportuar mbi orët e shërbimit të realizuara në përputhje me qëllimin e shërbimit të kërkuar, apo çdo dokument shoqërues që do të duhet për raportimin e shërbimit.
- Të mundësojë dorëzimin e raportit të punës, sipas afateve të përcaktuara

Kriteret për aplikimin:

Dokumentacioni i mëposhtëm duhet të dorëzohet brenda datës 28 Gusht 2019, në adresën elektronike të organizatës shoqata.rpkk@gmail.com :

1. Diplomat Master Shkencor ose Phd në Shkenca Ekonomike apo Sociale
2. CV dhe kualifikimet përkatëse;
3. Letër interesi, duke përshkruar aftësitë në përmbushjen e shërbimit të kërkuar;
4. Kontaktet e 3 referencave me të fundit; kopje të studimeve apo referenca të mëparshme të studimeve të kryera
5. Oferta financiare në total ose e ndarë në orë pune për shërbimet e kërkuara; oferta duhet të jetë në gros dhe të përfshijë tatimin në burim.

Të gjitha aplikimet do të trajtohen me konfidencialitet të plotë.

Vetëm kandidatët e përzgjedhur do të kontaktohen.



Ky projekt financohet nga
Bashkimi Evropian



Empowered lives.
Resilient nations.

Programi Rajonal mbi Demokracinë Vendore në Ballkanin Perëndimor – ReLOaD financohet nga Bashkimi Evropian dhe zbatohet nga Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP).